



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2625/1 Prot

Tiranë, më 27.12.2024

VENDIM

Nr. 44, datë 27.12.2024

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 2625 prot., datë 18.12.2024, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Bashkia Tiranë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, me anë të kërkesës datë 08.11.2024, depozituar pranë Autoritetit Publik, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Kontratat e lidhura me kompanitë që u është dhënë e drejta e shfrytëzimit për reklamim në rrugë, kryqëzime dhe hapësira të ngjashme përmes billboardëve, citylights, ekraneve led, banerave dhe të ngjashme.*

Autoriteti Publik nëpërmjet shkresës nr. 288128/1 prot., datë 05.12.2024, ka kthyer përgjigje ankuesit duke e sqaruar se: “...Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka lidhur kontrata me subjekte tregtare për shfrytëzim të hapësirave publike, referuar objektit të kërkesës tuaj. Ndodhur në kushtet ku institucioni nuk ka lidhur kontrata publike, ju informojmë se në zbatim të legjislacionit në fuqi që mbron të dhëna personale, informacionet e kërkuara prej jush kategorizohen si të dhëna personale, referuar ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar. Si të tilla, këto të dhëna mund të aksesohen nga ju vetëm duke depozituar deklaratë të dhënies së pëlqimit nga subjektet...” .

Ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën e regjistruar me nr. 2625 prot., datë 18.12.2024 duke sqaruar se: *“...përgjigjet e marra nga Autoriteti Publik nuk përmbushin kërkesën e bërë, ato janë të paqarta, kontradiktore dhe të pa bazuar në ligj... nuk kërkojmë të dhëna personale por kontrata të lidhura nga Bashkia Tiranë...”*.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”). Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Zyra e Komisionerit ka kontaktuar me koordinatorin për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, duke kërkuar që të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Koordinatori pranë Autoritetit Publik ka informuar Zyrën e Komisionerit, se ankuesi e ka marrë përgjigjen nëpërmjet shkresës nr. 288128/1 prot., datë 05.12.2024.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesës lidhet me kontrata publike, të lidhura nëpërmjet operatorëve ekonomikë apo sipas pretendimit të ngritur në shkresën nr. 288128/1 prot., datë 05.12.2024, persona privat dhe Autoritetit Publik.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr.288128/1 prot., datë 05.12.2024, ka njoftuar ankuesin duke mbajtur dy qëndrime të kundërta me njëri-tjetrin. Nga një anë pretendon se nuk mund t’ia vendosi në dispozicion dokumentacionin e kërkuar pasi nuk ka lidhur kontrata me subjekte tregtare dhe në qëndrimin tjetër pretendon se nuk mund t’ia vendosi në dispozicion dokumentacionin e kërkuar pasi përmban të dhëna personale në kuptim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, por mund të mundësojnë vetëm të dhëna të sintetizuara në lidhje me pagesën e detyrimeve për këtë kategori të shfrytëzimit të hapësirës publike.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj*”. Në kuptim të këtij parashikimi, Bashkia Tiranë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë është vetë ky autoritet që detyrohet për

zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.*

Nga përgjigja e kthyer nëpërmjet shkresës nr. 288128/1 prot., datë 05.12.2024, konkretisht në paragrafin e fundit të saj, Autoriteti Publik refuzon vendosjen në dispozicion të ankuesit, kontratat e lidhura, me pretendimin se nuk janë lidhur me subjekte tregtare dhe përmbajnë të dhëna personale në kuptim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, të ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se, refuzimi i mësipërm i Autoritetit Publik, bazuar në shkronjën a të pikës 1 të nenit 17 të LDI, e cila parashikon se: *“...E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private;...”*, vjen në kundërshtim me pikën 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit parashikohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Autoriteti Publik, duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të kontratës, të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të informacionit.

Për sa më sipër, informacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. _____, nr. 2625 prot., datë 18.12.2024, ndaj Autoritetit Publik, Bashkia Tiranë me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 08.11.2024, konkretisht: “*Kontratat e lidhura me kompanitë që u është dhënë e drejta e shfrytëzimit për reklamim në rrugë, kryqëzime dhe hapësira të ngjashme përmes billboardave, citylights, ekraneve led, banerave dhe të ngjashme.*”, brenda datës 10.01.2025.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 27.12.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi